




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 për Certifikim të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** më datë 28.08.2021 merr këtë:

V E N D I M



- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e partisë politike “**Lëvizja për Bashkim**” (LB) dhe listës prej 15 (pesëmbëdhjetë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Shtimes, listës prej 22 (njëzet e dy) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Vushtrrisë, listës prej 23 (njëzet e tre) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Obiliqit dhe listës prej 23 (njëzet e tre) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Prishtinës dhe 1 (një) kandidat për Kryetar të Komunës në Komunën e Obiliqit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
- II. Ky subjekt politik certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend Komunal në Komunën e Shtimes, Vushtrrisë, Obiliqit dhe Prishtinës, si dhe për Kryetar të Komunës në Komunën e Obiliqit.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj partinë politike **Lëvizja për Bashkim**, për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Subjekti politik i çertifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për radhitjen në fletëvotim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radonija  
Republika e Kosovës  
Prishtinë  
Prishtina

**Këshillë juridike:** Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.